

akt. shk. 154
12.05.09



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI



Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 222 260

2938
Nr. Prot
12.05
Tiranë, më 2009

URDHËR

Nr. 121, datë 12.05.2009

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË NDRYSHUAR TË SHKOLLËS SË LARTË
PRIVATE "JUSTINIANI I"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 15.03.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike, "Justiniani I" dhe Udhëzimit nr. 30, datë 26.09.07 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit të ndryshuar të shkollës së lartë private "Justiniani I", mbështetur në propozimin e komisionit të veçantë, të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 438, datë 26. 11. 2007, "Për ngritjen e komisionit të veçantë për shqyrtimin e kërkesave së bashku me praktikantët e plotë për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve", i ndryshuar.
2. Programi i studimit "Drejtësi" me kohëzgjatje 4 vite, ndryshon në program studimi të ciklit të parë "Drejtësi", me kohëzgjatje 3 vite në formën e studimeve me kohë të plotë.



ministra e arsimit dhe shkencës
ministra e së nesërmes
www.mash.gov.al

Urdhër për ndryshim programi Faqe 1 nga 2



3. Shkolla e lartë private "Justiniani I", në përfundim të programit të studimit të përmendur në pikën 2 të këtij urdhri do të lëshojë Diplomë të Nivelit të Parë, (DNP) në Drejtësi.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Fatos Beja
FATOS BEJA

21.04.2019

MINISTRIMI I PROGRAMIT TË NDRYSHILAR TË SHKOLLËS SË LARTË
PRIVATE "JUSTINIANI I"

